

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE**

Nr. prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/ 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

Drejtuar: **Operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” sh.p.k**

**Adresa:** Tirane, Rruga "Murat Toptani", Godina Eurocol, Kati 8

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbim

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: REF-13409-07-17-2024, “Abonime dhe rinovime licensash per aplikacionet software”,

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [22/07/2024] [40]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, NIPT J61817047D**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 5,351,820 (pesë milion e treqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = 6,422,184 (gjashtë milion e katërqind e njëzet e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

**2. Operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SH.P.K, NIPT K21710002J**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 6,242,400 (gjashtë milion e dyqind e dyzet e dy mijë e katërqind) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = 7,490,880 (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë.

**3. Operatori ekonomik “ INFORMATION BUSINESS SYSTEMS -IBS” SH.P.K, NIPT J61820057C**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 6,399,000 (gjashtë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = 7,678, 800 (shtatë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.

#### **4. Operatori ekonomik “Axians Albania” SH.P.K, NIPT K52207006Q**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 7,228,932 (shtatë milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = 8,674,718.40 (tetëmilion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë pikë dyzet) lekë.

#### **5. Operatori ekonomik “Fastech” SH.P.K, NIPT J81609010U**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 7,385,000 (shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = 8,862,000 (tetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

##### **1. Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, NIPT J61817047D**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 82 pika 2 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

Në mbështetje të nenit 93 e Ligjit Nr. 162/2020 për “Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Komisioni verifikoi nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentat standarde të tenderit dhe në përcaktimin e nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), nga ku konstatoi se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik është ofertë anomalisht e ulët referuar sa më poshtë vijon: ...*“Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.*

*Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

*- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.; ... ”

Nga përlogaritjet e kryera referuar kushtit të sipërcituar rezulton:

Vlera e ofertuar nga operatori ekonomik është 5,351,820 (pesë milion e treqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa T.V.SH.

$MO = (5,351,820 \text{ (BNT)} + 6,242,400 \text{ (ABS)} + 6,399,000 \text{ (IBS)} + 7,228,932 \text{ (AXIANS)} + 7,385,000 \text{ (FASTECH)}) / 5$

$MO = 6,521,430.40$

$PR = 85 \% Mo$

$PR = 5,543,215.84$

**Vlera e ofertuar e Operatorit Ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k është më e vogël se 85% i mesatares së ofertave të vlefshme si rrjedhojë oferta oferta është anomalisht e ulët.**

Referuar sa më sipër dhe në mbështetje të Nenit 93, Pika 5 e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024 ”Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020”, Neni 27 i këtij të fundit, ku citohet se:

*“Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:*

*“5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”*

**Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon njëzëri se operatori ekonomik “BNT Electronics” shpk, s’kualifikohet nga Procedura e prokurimit me objekt “Abonime dhe rinovime licensash për aplikacionet software” me Nr. reference REF-13409-07-17-2024.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [“**Advanced Business Solutions - ABS” sh.p.k me adresë:** Tirane, Rruga "Murat Toptani", Godina Eurocol, Kati 8], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 6,242,400 (gjashtë milion e dyqind e dyzet e dy mijë e katërqind) lekë pa tvsh është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.